

## SEMINARI PERMANENT “PËRTHYERJE ANTROPOLOGJIKE”

Tiranë, janar – maj 2019

I konceptuar si një aktivitet i përhershëm i Departamentit të Etnologjisë, në Institutin e Antropologjisë Kulturore dhe Studimit të Artit (ASA) dhe i organizuar në bashkëpunim me Bibliotekën Kombëtare të Shqipërisë, ky seminar ka si qëllim zhvillimin e një serie takimesh të rregullta, ku prezantohen monografi, studime, projekte kërkimore, si dhe filma antropologjikë. Zhanret e shqyrtimit apo dokumentimit të jetës së përditshme janë objekt i prezantimit dhe debatit të hapur. Synimi kryesor i këtij aktiviteti është krijimi i një mjedisi ku mundësohen përthyerje pikëpamjesh antropologjike mbi kulturën dhe shoqërinë.

Në vijim, po paraqesim përmbledhje të shkurtra rreth fjalëve të secilit prej ligjëruesve të ftuar.

**Lumnije Kadriu:** *Pushimet, familja, vendlindja  
në praktikatat e diasporës shqiptare të Kosovës*

25 janar 2019

Lumnije Kadriu, studiuese në Institutin Albanologjik të Prishtinës, referoi mbi risitë që sjell monografia e saj me titull *Pushimet, familja, vendlindja në praktikatat e diasporës shqiptare të Kosovës* (Prishtinë: Instituti Albanologjik 2017). Ajo foli për përvojat e migrimit të shqiptarëve, vizitat e bëra në vendlindje dhe në familje, si dhe pushimet e mërgimtarëve në vendlindje. Ky hulumtim ishte fokusuar në atë se cilët janë aktivitetet kryesore në të cilat angazhohen mërgimtarët gjatë kohës kur janë për pushime në vendlindje, duke shpalosur edhe shumë çështje të tjera komplekse e me interes për mërgimtarët, por edhe me punën kërkimore të vetë autores.

**Shemsi Krasniqi:** *Etnokultura – ripërfytyrim i natyrës  
në kulturën tradicionale*

29 mars 2019

Shemsi Krasniqi është lektor në Departamentin e Sociologjisë në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Tema e këtij seminari trajtonte mënyrën e ripërfytyrimit të natyrës në kulturën tradicionale shqiptare. Në këtë kontekst, termi “ekokulturë” është përdorur për t’i paraqitur të gjitha ato elemente të kulturës tradicionale të cilat në përmbajtjen e tyre, në mënyrë implicite apo eksplicite, mbartin mesazhe ekologjike dhe paraqesin bazat e një etike mjedisore. Qëllimi kryesor i këtij studimi është identifikimi i elementeve të një etnoekologjie shqiptare, përkatësisht nisja e një fushe studimesh antropologjike mbi mënyrën e të kuptuarit të natyrës në kulturën tradicionale shqiptare. Pas parashtrimit të metodologjisë së hulumtimit, autori paraqet disa elemente të ekokulturës, si: ahti/afti, nëma, bekimi, betimi, metamorfoza, empatia, komunikimi, hiri, shëmbëllimi dhe shenjtërimi, elemente këto që hasen si në praktikatat e përditshme të jetës reale, ashtu edhe në krijimet imagjinare, në besimet popullore, në folklor, mitologji dhe në traditën orale përgjithësisht. Këto elemente u trajtuan si pjesë përbërëse të ekokulturës, për shkak se përveç karakterit filozofik, mistik, etik, stilistik dhe estetik, ato kanë edhe karakter ekologjik. Duke krijuar vlera dhe norma të caktuara të sjelljes në raport me natyrën, ne konsiderojmë se këto elemente kanë vepruar edhe si mekanizma kulturorë për ruajtjen e ekosistemit dhe baraspeshës ekologjike. Në pjesën e dytë, u trajtua shkurtimisht arti shkëmbor i Kosovës, me tipologjinë e simboleve dhe interpretimin e tyre. Simbolet e gdhendura, ose pikturuara në gurë, janë shprehje spirituale dhe intelektuale të paraardhësve tanë dhe gjurmojnë disa probleme që lidhen me qenien njerëzore e që janë universale, të gjithëkohshme dhe të kudondodhura, pavarësisht koordinatave kohore dhe hapësinore. Arti shkëmbor paraqet një simbiozë të kulturës me natyrën. Në fund, u paraqitën gjetjet kryesore nga kërkimet shumëvjeçare në terren të Krasniqit, në përcjellje të festave popullore dhe praktikave rituale të lidhura me natyrën, si pelegrinazhet në male, ritet e kalimit në gurë, festat sezonale dhe kultet e lisave të vjetër në Kosovë. Të gjitha këto tema u integruan reciprokisht në funksion të idesë së ekokulturës.

Në funksion të kësaj ideje shoqëronte aktivitetin edhe ekspozita “Arterren”. Fjala është për fotografi të bëra gjatë punës kërkimore në terren dhe që paraqesin njerëzit, natyrën, trashëgiminë kulturore, materiale, shpirtërore dhe natyrore të Kosovës. Ndër të tjera, ekspozita “Arterren” mbart edhe një mesazh për hulumtuesit: gjatë punës empirike në terren, mund të bëhen edhe fotografi artistike. Përfshirja e dimensionit artistik në hulumtimin empirik, vetëm sa e pasuron dhe përplotëson hulumtimin.

**Florina Jerliu:** *Trashëgimia kulturore e Kosovës: koncepte dhe kontekste të mbrojtjes*

26 prill 2019

Florina Jerliu, lektore e historisë, teorisë dhe trashëgimisë arkitekturale në Universitetin e Prishtinës, tregoi se Kosova ka trashëguar një fond të jashtëzakonshëm të trashëgimisë kulturore, i cili fatkeqësisht nuk u hulumtua dhe nuk u integrua në mënyrë objektive në sistemin e mbrojtjes pas Luftës së Dytë Botërore, kur edhe vendoset kronologjikisht sistemi i administrimit të trashëgimisë kulturore në Kosovë. Ky sistem ishte hallkë e një programi kompleks të Serbisë që ndoqi kauzën e çintegritit të elementit shqiptar dhe të diversitetit të shprehjes kulturore të popullit të Kosovës, të nisur që me rënien e Perandorisë Osmane dhe pushtimin e saj nga Serbia. Sot, trashëgimia kulturore e Kosovës, e mbrojtur me ligj, reflekton synimet shtetërore për përfaqësim objektiv të vlerave materiale dhe jomateriale të kulturës kosovare. Megjithatë, ajo vazhdon t’i ndiejë pasojat e politikës së diferencimit etnik, të trashëguara nga listat e regjimit të kaluar serb. Edhe Aneksi V i Planit të Ahtisaarit mbi trashëgiminë fetare (kryesisht ortodokse) bashkë me dokumentet tjera obliguese ndërkombëtare për Kosovën, kanë luajtur rol qenësor në përcaktimin e kornizës territoriale dhe juridike të një pjese të trashëgimisë kulturore në Kosovë, e cila si pasojë ka aktualizuar konceptin e identiteteve të lokalizuara, të formësuara përgjatë linjave etnike. Efekt i drejtpërdrejtë i këtij aspekti të ri kulturor dhe politik mbetet nënshtrimi i qendrave historike ndaj ndërtimeve të pakontrolluara, si dhe

përrjashtimi i trashëgimisë së tyre kulturore nga procesi i planifikimit urban dhe ndërtimit të identitetit kulturor në linjë me konceptet evropiane.

**Linda Gusia:** *Amësia politike dhe mobilizimi i grave në Kosovë*

31 maj 2019

Linda Gusia ligjëruese në Universitetin e Prishtinës, në Departamentin e Sociologjisë shpalsi tek prezantimi i saj angazhimin e grave në proceset politike dhe paraqitjen e tyre në sferën publike përgjatë viteve '90 në Kosovë. Në frymën e protestave paqësore, gratë aktiviste ishin të parat që reagueshan dhe u mobilizuan ndaj përshkallëzimit të dhunës që mori hov në ato vite. Ashtu siç kanë dëshmuar hulumtimet e vetëdijshme për veçoritë gjinore, gratë dhe burrat marrin pjesë në mënyra të ndryshme në projektin e shtetformimit. Ndërlidhja e kombit me gjininë nuk ka qenë gjithmonë e dukshme në ligjërimin, analizën dhe kërkimet mbi kombet, megjithatë kombet nuk janë neutrale ndaj gjinisë. Roli i grave në projektet kombëtare shpesh përshkruhet si simbolik, pasi gratë supozohet të kenë mishëruar kufijtë dhe nderin e kombit. Në Kosovë, ligjërimi i amësisë ka qenë qendror mes grave politikisht të angazhuara në rezistencë paqësore. Shfrytëzimi i konceptit dhe simbolikës së amësisë si formë e mobilizimit të grave përshtatej me filozofinë e përgjithshme të rezistencës paqësore dhe idiomat kombëtare në përgjithësi. Në kontekstin e Kosovës, sfera private dhe familja ishin më së shumti strehë e konsolidimit të rezistencës dhe jo hapësirë ku rishqyrtoheshin pabarazitë dhe padrejtësitë në të. Kjo krijoi përvoja që e dallojnë Kosovën nga vendet e tjera në rajon, duke krijuar mundësi të reja të mobilizimit të grave. Kufizimet e imponuara jo vetëm nga shoqëria tradicionale, por edhe nga sistemi shtypës, gjithashtu patriarkal, e bëjnë këtë pozicion të shfrytëzueshëm. Edhe pse ky mobilizim nuk është domosdoshmërisht për gruan dhe në emër të gruas, ai ka krijuar agjenci dhe ka shtruar rrugën për lëvizje të grave në Kosovë. Përderisa sot, lëvizjet feministe ngjallin globalisht shpresën e krijimit të asaj që Nancy Fraser e quan “kontrapublikja subalterne”, kërkimet dhe dokumentimet rreth

rezistencave lokale krijojnë hapësira kujtese mbi proceset e caktuara historike dhe sociale, si dhe mënyrat e ndryshme se si gratë janë përvijuar jo vetëm në rrafshin simbolik të sakrificës dhe kujdesit për kombin, por edhe si subjekte që flasin.

Përgatitur nga Blerina HANKOLLARI dhe Mikaela MINGA

